



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i godines dhe qendres ne Lagjen 1 Maj ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45236290-9** Punime riparimi për zona rekreacioni

VLERA E FONDIT **29,166,667** (Njëzet e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë** pa TVSH

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:
a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet

operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter

kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vi. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NP.1 – Punime Germimi ne toke

Klasifikimi A

- **N.P. 3** - Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
Klasifikimi A

▪ **Për punimet speciale të ndërtimit :**

- **N.S -1** Punime për prishjen e ndërtimeve **Klasifikimi A**
- **N.S-2** Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre. **Klasifikimi A**
- **NS-4** – Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertue **Klasifikimi A**
- **N.S -6-** Sinjalistika rrugore jodriçuese **Klasifikimi A**
- **N.S- 14** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV **Klasifikimi A**
- **NS-18** – Punime topogjeodezike – **Klasifikimi A**

* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

			respektive	
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Punime gërmimi dhe, Punime prishje, Punime gërmimi shkëmbi i fortësive të ndryshme me ekskavator Kapitull 1 dhe 2 I preventivit	A	0-21 milion
NP-3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Kapitujt 5, 6, 9, 10, 11, 13, 16, 17, 18, 19, 20 te preventivit	A	0-21 milion
N.S -1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.	A	0-21 milion
N.S-2	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme	A	0-21 milion
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese	Rifiniture e muraturave të përfunduara	A	0-21 milion
NS -6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Sinjalistike rrugore jodriçuese	A	0-21 milion
N.S- 14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.	A	0-21 milion

NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	A	0-21 milion
-------	-----------------------	-----------------------	---	-------------

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (*Sistem i Menaxhimit te Cilesise*)
- **ISO 14001:2015** (*Sistem i Menaxhimit Mjedisor*)
- **ISO 45001:2023** (*Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune*)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arrijten e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.
- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e

kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2023: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2023, standart ky qe përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimal dhe menaxhimit të sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollat e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **45 (dyzetë e pesë) punonjës**, me koë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **45 (dyzetë e pesë)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për*

ekzekutimin me sukses të kontratës”. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik të punimeve si më poshtë:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohej në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të

kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa per 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve që lidhen me veprat hidroteknike, sistemet e drenazhimit, menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe elementët e tjerë të infrastrukturës hidraulike që përfshihen në objekt.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për organizimin, koordinimin dhe kontrollin teknik të punimeve civile dhe strukturore, duke garantuar zbatimin e projektit sipas specifikimeve teknike dhe legjislacionit në fuqi.

Inxhinieri Gjeodet/Topograf kërkohet për kryerjen e matjeve topografike, piketimin e objektit, kontrollin e kuotave dhe koordinatave, si dhe për verifikimin e saktësisë së zbatimit të punimeve në terren.

Inxhinieri Elektroteknik është i nevojshëm për realizimin dhe mbikëqyrjen e instalimeve elektrike, sistemeve të furnizimit me energji, ndriçimit dhe elementëve të tjerë elektromekanikë të parashikuar në projekt.

Inxhinieri Mekanik kërkohet për instalimin, kontrollin dhe vënien në funksion të pajisjeve mekanike dhe elektromekanike, si dhe për garantimin e funksionimit të tyre sipas parametrave teknikë të projektit.

Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Minimumi 1(një) **Inxhinier profili Gjeoteknike;**
- Minimumi 1(një) **Inxhinier/Specialist i pajisur me certifikate për testimin e performancës së produkteve të ndertimit, (leshuar nga Instituti i Ndertimit ose subjekte të licensuara akredituese);**

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Shenim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka leshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me sipër.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinieri i profilit Gjeoteknik është i domosdoshëm për vlerësimin e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit, analizimin e qëndrueshmërisë së tokës, si dhe për garantimin e zbatimit korrekt të zgjidhjeve inxhinierike në lidhje me themelet dhe strukturat mbështetëse të objektit.

Inxhinieri/Specialisti i certifikuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit

kërkohet për të siguruar që materialet dhe produktet e përdorura në ndërtim përmbushin standardet teknike dhe kërkesat e cilësisë, duke kryer testimet përkatëse dhe verifikimet e performancës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe normat teknike të aplikueshme.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

c) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Teknik topograf- jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Elekticiste- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Mekanik - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Pllakashtrues- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hidroizolues- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Murator/suvatues- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Bojaxhi- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hidraulike- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Sisteme ngrohje-ftohje- jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Duralumin- jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hekurkthyes jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Betonues jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Karpentier - jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Termoizolues- jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Specialist punime guri- jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Specialist për punime druri- jo më pak se **1 (nje)** punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 mujore.

- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka leshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Argumentimi

Kërkesa për disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar sipas profileve të ndryshme profesionale është vendosur në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë zërash teknike dhe kërkojnë kapacitete të ndryshme profesionale për realizimin e tyre.

Ky staf është i domosdoshëm për të garantuar realizimin cilësor, të sigurt dhe në përputhje me standardet teknike të të gjitha fazave të punimeve, duke përfshirë punimet strukturore, instalimet, përfundimet dhe punimet e specializuara.

Teknik ndërtimi dhe Teknik topograf sigurojnë organizimin dhe kontrollin teknik në terren, si dhe saktësinë e zbatimit të projektit sipas kuotave dhe specifikimeve teknike.

Elektricitet, mekanikë, specialistët e sistemeve ngrohje-ftohje dhe hidraulikë janë të nevojshëm për realizimin e instalimeve teknike dhe garantimin e funksionalitetit të sistemeve të ndërtesës.

Pllakashtruesit, hidroizoluesit, muratorët/suvatuesit, bojaxhinjtë, termoizoluesit, specialistët e punimeve të drurit dhe duraluminit sigurojnë realizimin e punimeve të rifiniturës dhe përfundimit të objektit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë estetike dhe funksionale të tij.

Hekurkthyesit, betonuesit dhe karpentierët janë thelbësorë për realizimin e strukturës mbajtëse të objektit, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë konstruktive.

Specialistët e punimeve të gurit dhe materialeve të tjera specifike sigurojnë realizimin e elementeve të veçanta arkitektonike dhe funksionale të projektit.

Kërkesa për numrin minimal të punonjësve për çdo profil është vendosur në mënyrë proporcionale me volumet dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e kontratës brenda afateve dhe standardeve të kërkuara.

Detyrimi që punonjësit të jenë të pajisur me kontrata pune të vlefshme, certifikata/diploma profesionale dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për një periudhë minimale prej 3 muajsh, synon të garantojë ekzistencën reale të stafit, stabilitetin e marrëdhënieve të punës dhe shmangien e deklarimeve formale apo të përkohshme vetëm për qëllime kualifikimi.

Ky kriter është në përputhje me parimet e **ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**, duke siguruar konkurrencë të ndershme, transparencë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë, pa vendosur kufizime të panevojshme, por vetëm kërkesat minimale të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar në liçencë 1 (një) Punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” gjatë kryerjes së veprimtarisë , në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10431 datë

09/06/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/çertifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një)** punonjës si “*Ekspert zjarrfikës*”, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. (Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet e MNZ).

Argumentimi:

Kërkesa për disponimin e një Eksperti për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin (MNZ) është vendosur në funksion të garantimit të sigurisë së punimeve dhe respektimit të kërkesave ligjore dhe teknike në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

Ky specialist është i domosdoshëm për të siguruar:

zbatimin korrekt të masave parandaluese dhe mbrojtëse nga zjarri gjatë fazës së ndërtimit dhe/ose gjatë funksionimit të objektit;
vlerësimin e rreziqeve të mundshme dhe hartimin/ndjekjen e masave të sigurisë;
përputhshmërinë e punimeve me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me Ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe aktet nënligjore përkatëse.

Kërkesa që eksperti të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi zyrtare të lëshuar nga autoritetet kompetente, si dhe të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik dhe i pasqyruar në listëpagesa për një periudhë minimale prej 3 muajsh, synon të garantojë ekzistencën reale të kapacitetit profesional dhe përfshirjen efektive të tij në realizimin e kontratës.

Ky kusht është vendosur në mënyrë proporcionale dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, duke synuar rritjen e nivelit të sigurisë në kantier, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve, si dhe minimizimin e risqeve gjatë realizimit të projektit.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, plotësimi i këtij kriteri nga një prej anëtarëve të bashkimit është i pranueshëm, duke respektuar ndarjen funksionale të punimeve dhe përgjegjësi brenda bashkimit, pa cenuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Kriteri është në përputhje me parimet e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke siguruar konkurrencë të ndershme, proporcionalitet dhe garanci për realizimin e kontratës në kushte sigurie dhe cilësie të plotë.

- c) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (*nga Administratori i shoqërisë*) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që

ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuasi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuësve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Manovratore/Eskavatoriste – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Shofer – jo më pak se 2 (dy) punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilit të deklaruar për çdo punojes.
- Të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojesit e mësipër duhet të figurojnë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Agumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine	2 copë	Pronësi ose me qera
Damper me targa	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator te jashtem	5 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Nivelues betoni helikopter	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik me benzin	2 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri fasade	500m2	Pronësi ose me qera

Makine per ngjitje tubash	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 30 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 3 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 3 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 15 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për

të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

Kërkesa për disponimin e automjeteve, makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në tabelë është vendosur në funksion të natyrës, volumit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë punime të ndryshme ndërtimore, gërmimi, transporti, betonimi, instalimi dhe përfundimi.

Disponimi i këtij kapaciteti teknik është i domosdoshëm për të garantuar:

- realizimin në kohë të punimeve dhe respektimin e afateve kontraktuale;
- cilësinë e punimeve sipas standardeve teknike dhe projektit;
- vazhdimësinë e proceseve të punës pa ndërprerje për shkak të mungesës së pajisjeve;
- rritjen e sigurisë dhe eficiencës në kantier.

Kamionët vetëshkarkues, kamionçinat dhe damperat janë të domosdoshëm për transportin e materialeve të ndërtimit, dherave dhe mbetjeve inerte, duke siguruar menaxhim efektiv të volumit të punimeve.

Eskavatorët, fadromat, minifadromat dhe minieskavatorët janë thelbësorë për punimet e gërmimit, sistemit të terrenit dhe përgatitjes së bazës së ndërtimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe saktësinë e realizimit të projektit.

Betonieret, autobetoniere dhe autopompa betoni sigurojnë furnizimin dhe vendosjen e betonit në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas parametrave teknike, duke garantuar cilësinë strukturore të objektit.

Vincat me kosh, skelat e fasadës dhe pajisjet për punime në lartësi janë të nevojshme për realizimin e punimeve në lartësi dhe fasadë, duke garantuar sigurinë e punonjësve dhe aksesin teknik në të gjitha pjesët e objektit.

Vibratorët e betonit, niveluesi (helikopteri), pllaka vibruese dhe pompa e suvatimit janë pajisje esenciale për përpunimin dhe kompaktimin e materialeve, duke siguruar cilësi të lartë të strukturës dhe përfundimeve.

Gjeneratorët dhe pajisjet ndihmëse garantojnë vazhdimësinë e punimeve në rast mungese energjie dhe mbështesin funksionimin e pajisjeve të tjera në kantier.

Makineritë për punime hekurkthimi dhe instalime tubacionesh janë të domosdoshme për realizimin e elementeve strukturore dhe rrjeteve teknike të objektit.

Kërkesa që këto mjete të jenë në pronësi ose me qira synon të sigurojë fleksibilitet në mënyrën e organizimit të operatorëve ekonomikë, duke mos kufizuar konkurrencën, por duke garantuar disponueshmërinë reale të kapaciteteve teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi synon të sigurojë kapacitet minimal teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të punimeve, pa krijuar barriera të panevojshme për pjesëmarrje në tender.

2.3.8 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë, operatorët ekonomike duhet të grantojnë cilësinë e materialeve për realizimin e objektit, si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------|--------------|
| o Materiale elektrike | o Katrama |
| o Materialet hidraulike | o Polisterol |
| o Materialet hidro-sanitare | o Parket |
| o Sistem ngrohje | o Bojera |

a) Per materialet me siper, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ne sistemin e prokurimit publik Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

b) Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin

Argumentimi i kriterit

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit/distributorit dhe katalogëve teknikë për materialet e përcaktuara në specifikimet teknike është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë, origjinës dhe përputhshmërisë së materialeve që do të përdoren në realizimin e objektit të kontratës.

Materialet si elektrike, hidraulike, hidro-sanitare, sistemet e ngrohjes, katrama, polisteroli, parketi dhe bojërat përbëjnë elementë kritikë të punimeve ndërtimore, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe cilësinë përfundimtare të objektit.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar synon të garantojë që operatori ekonomik ka akses të ligjshëm dhe të verifikueshëm në produktet origjinale, duke shmangur përdorimin e materialeve të pasigurta, jo origjinale ose jashtë standardeve teknike të kërkuara. Kjo gjithashtu siguron gjurmueshmërinë e produkteve dhe përgjegjësinë e qartë në zinxhirin e furnizimit (prodhues–distributor–ofertues). Lejimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të formalizuara synon të rrisë konkurrencën dhe të mundësojë pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, pa cenuar standardet e cilësisë. Kërkesa për katalogë ose fragmente katalogësh teknikë të prodhuesit shërben për të identifikuar qartë specifikimet teknike të materialeve të ofruara, duke mundësuar verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kjo ndihmon autoritetin kontraktor të sigurohet se produktet e propozuara plotësojnë parametrat teknikë të kërkuar dhe janë të krahasueshme ndërmjet ofertuesve.

Kërkesa për paraqitje të dokumentacionit në gjuhën shqipe (ose të përkthyer dhe noterizuar) garanton transparencën, kuptueshmërinë dhe vlerësimin e saktë të dokumenteve gjatë procedurës së vlerësimit.

Në tërësi, këto kërkesa janë proporcionale me objektin e kontratës dhe të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e materialeve që do të përdoren, duke synuar sigurimin e cilësisë së punimeve, mbrojtjen e interesit publik dhe realizimin me sukses të kontratës, në përputhje me parimet e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” mbi transparencën, konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) **Kodi III.2.B** *“Grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta inerte”* Ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Per disa ndryshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”

Argumentim : Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kodi III.2.B “Grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta inerte”, është vendosur në funksion të garantimit të menaxhimit të sigurt, ligjor dhe mjedisor të mbetjeve që krijohen gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate.

Gjatë zbatimit të kontratës do të gjenerohen mbetje inerte si rezultat i punimeve të gërmimit, prishjeve, sistemimeve dhe proceseve të tjera ndërtimore. Trajtimi i këtyre mbetjeve kërkon kapacitete të specializuara dhe të autorizuara ligjërisht për grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e tyre në vendet e miratuara.

Licencimi sipas Kodit III.2.B siguron që operatori ekonomik:

- vepron në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi;
- garanton transportin e mbetjeve në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt;
- shmang depozitimet e paligjshme dhe ndikimet negative në mjedis;
- kontribuon në mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit natyror.

Kërkesa bazohet në Ligjin nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, i ndryshuar, si dhe në kuadrin rregullator për licencat dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar që subjektet që kryejnë këtë aktivitet të jenë të autorizuara dhe të kontrolluara nga institucionet kompetente.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me fazën e zbatimit të punimeve, duke siguruar respektimin e standardeve mjedisore dhe menaxhimin korrekt të mbetjeve ndërtimore, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën në procedurën e prokurimit publik.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, i Preventivin si dhe analizen e cmimeve për zerat e preventivit, (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE grafikun e punimeve duhet të jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Specifikimet teknike jane hartuar ne zbatim te nenit 36 te ligjit nr.162/2020 “ Per prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

Specifikimet teknike jane hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do te bashkengjiten dokumentave te tenderit ne SPE.

NJESIA E PROKURIMIT